




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dokumenti Registration / Document E datës / Dated Date	04-03-2021	viti / god year	1
Organ / Institucioni Org. / Inst.	978/2021	Shtesa / Prilog Appendix	113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr. 18/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga:** Arben Mehmeti kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me zyrtaresen e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtëses kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.18/2021 të datës 19.01.2021, të parashtruar nga ankuesi me banim në Rr. “Muharrem Shemsedini” lagjja Naim Beka Ferizaj, kundër organit të punësimit- Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.03.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET si e bazuar** ankesa A.nr.18/2021 e datës 19.01.2021 e parashtruar nga ankuesi

**II. SHFUQIZOHET** Vendimi me numër 516 i datës 24.12.2021 i Drejtorit të Qendrës Korrektuese për të Mitur në Lipjan.

**V. OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, prej ditës së pranimit të këtij vendimi.

**VI.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**VII.** Vendimi hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga ana e kryetarit të kolegjit.

**A r s y e t i m**

Ankuesi në pozitën zyrtar korrektues sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 01.07.2018, me Vendimin e datës 24.12.2020 me numër protokollit 519 të Drejtorit të Qendrës Korrektuese për të Mitur në Lipjan, shpallet fajtor dhe i shqiptohet masa disiplinore vërejtje për shkak të dëmtimit të armës



zyrtare "glock 19 nr.RBV-425", sipas raportit të instruktorëve nga sektori i armëve të zjarrit dhe trajnimeve të SHKK-së i datës 23.12.2020.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin e datës 24.12.2020 me numër protokollit 519 të Drejtorit të Qendrës Korrektuese për të Mitur në Lipjan, me datë 19.01.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 207/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 22.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Më datë 25.01.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përmes e-mailit bashkë me provat e lëndës faqe 1/15.

**Administrimi i Provave-Kolegji** për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 207/2020 e datës 19.01.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 24.12.2020 me numër protokollit 519 për Shqiptimin e Masës Disiplinore nga Drejtori i Qendrës Korrektuese për të Mitur në Lipjan; Njoftim i datës 04.12.2020 nga ankuesi për dëmtimin e armës zyrtare me datën 18.11.2020; E-mail zyrtar i datës 25.01.2021 nga Menaxheri i Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 23.12.2020 njoftim mbi deponimin e armëve Glock-19; Inicim i procedurës disiplinore ndaj zyrtar korrektues i datës 08.12.2020; E-mail zyrtar i datës 21.12.2020; E-mail Zyrtar i datës 04.12.2020; Foto e armës së dëmtuar; Raport mbi kontrollimin rutinor të armëve të stafit të datës 04.12.2020; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 01.07.2018 dhe Përgjigje në ankesë e datës 25.01.2021 përmes e-mailit zyrtar bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/15.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e **bazuar**, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili kërkon që të shqyrtohet ankesa dhe Vendimi i datës 24.12.2020 me numër protokollit 519 i Drejtorit të Qendrës Korrektuese për të Mitur në Lipjan të anulohet sepse vërejtja është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Drejtori i Qendrës Korrektuese për të Mitur në Lipjan me datën 08.12.2020 ka inicuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit në Komisionin Disiplinor për shkelje të rëndë të detyrave të punës bazuar në nenin 46 paragrafi 3 pika 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, dhe nenit 47 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pasi që nga raporti i kontrollit të armëve i datës 04.12.2020 nga ana e sigurimit të institucionit raportohet se arma "glock nr.RBV-425" të cilën e posedonte ishte e dëmtuar në këmbëz dhe dorëz.

Pas këtij raporti dhe deklaramit të ankuesit, Drejtori i Qendrës Korrektuese për të Mitur në Lipjan vendosi që ankuesit ti shqiptojë masën disiplinore vërejtje bazuar në nenin 47 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, për arsye se ankuesi ka qenë i obliguar që armën e zjarrit me të cilën ka qenë i ngarkuar ta vendos në vende të sigurta e jo në vende të ekspozuara dhe të pasigurta. Po ashtu pas konstatimit të vlerës së dëmit me vendim të veçantë do të kërkohej nga ankuesi që të bëjë kompensimin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se vërejtja e shqiptuar me datën 24.12.2020 me numër protokollit 519 nga Drejtori i Qendrës Korrektuese për të Mitur në Lipjan është në kundërshtim me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 8

paragrafi 2 i Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: „Masa disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar se Drejtori i Qendrës për të Mitur në Lipjan me rastin e shqiptimit të vërejtjes të datës 24.12.2020 me numër protokollit 519 ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, sepse në këtë rast nuk e ka shqiptuar vërejtjen mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, që bie ndeshë me dispozitat ligjore të nenit 47 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 8 paragrafi 2 i Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë .

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda Nr.A.nr. 18/2021, datë 04.03.2021**

Sabile Avdyli  
  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.